



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 11.05.2021

- I. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 06.05.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “**International Security Association**” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës**”, me Nr. të Prok: 632-21-2094-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-21-035-211. nxjerr:

### V E N D I M

- II. 1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “**International Security Association**” SH.P.K., e dt. 06.05.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës**”, me Nr. të Prok: 632-21-2094-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-21-035-211., kundër Njoftimit për kontratë, te AK –së, të datës 19.04.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. Vërtetohet NJOFTIMI PËR KONTRATË, të publikuar me datë: 19.04.2021;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

## Arsyetim

- I. Operatori Ekonomik "International Security Association" SH.P.K., me datë 06.05.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës", me Nr. të Prok: 632-21-2094-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-21-035-211.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 11.05.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Kërkesa e juaj për rishqyrtim është e pa bazë sepse Autoriteti kontraktues konsideron se nuk ka bërë shkelje të nenit 9 dhe 28 të LPP-ë, pasi që ka përcaktuar se nevojat që duhet përmbushur konform specifikave teknike.

AK sqaron se numri i orëve të parashikuar për 2 vite është 157248 orë, kjo sasi orëve është sasi indikativë po ashtu edhe pozicionet individuale janë sasi indikativë.

Çdo informatë sasiore është dhënë në tabelë tek aneksi 1 i dosjes së tenderit që është edhe informacion indikativ që shërben për ofertim.

Sasia e parashikuar në tabelë është vetëm sasi indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është 30% +/-.

Andaj ky fakt mjafton që kërkesa e juaj të konsiderohet e pa bazë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

### Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

  
Faton Gutaj  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës